

Dr. Erinda Misho është diplomuar për Drejtësi në vitin 2004 në Universitetin Jug-Perëndimor “Neofit Rilski” Fakulteti i Drejtësisë, në Bullgari.

Nga viti 2021 mban gradën Doktor Shkencash nga Universiteti Jug-Perëndimor “Neofit Rilski”, Fakulteti i Drejtësisë, Departamenti i të Drejtës Ndërkombëtare në Bullgari.

Nga viti 2021 dhe në vazhdim është Avokate Shteti pranë Zyrës së Përfaqësimit në Gjykatat e Huaja, Ndërkombëtare dhe në Arbitrazhin Ndërkombëtar, Avokatura e Shtetit.

Nga viti 2018-2021 ka punuar pedagoge me kohë të plotë dhe ka qenë Zv/Përgjegjëse e Departamentit të Mjedisit pranë Universitetit “Polis”, Tiranë.

Gjatë periudhës 2005-2018 ka punuar për Ministrinë e Mjedisit duke mbajtur pozicione të ndryshme. Kryesisht puna ka konsistuar duke punuar për Kapitullin 27 dhe për nën-kapitujt e tij, në përafrimin e direktivave të BE-së, në hartim legjislativ, hartim padish/ankimesh, përfaqësim në gjykata, pjesëmarrje në grupe pune / komisione për lejet mjedisore, për vlerësime të ndikimit në mjedis, projekte mjedisore, prokurime si dhe hartim korrespondencash me subjektet dhe institucionet publike.

Ajo është trajnuar dhe zotëron kualifikime dhe diploma të ndryshme nga Institucione Ndërkombëtare si nga Japan International Cooperation Agency (JICA) - Japoni, Universiteti Ndërkombëtar i Venecias - Itali, Central Eastern University (CEU) - Hungari, në Universitetin e Oksfordit, EPA, Bristol, Angli, etj. Ajo ka marrë pjesë në disa projekte në Shqipëri dhe jashtë vendit, si këshilltare ligjore, eksperte vendase apo ndërkombëtare për çështje që lidhen me të drejtat e mjedisit dhe krimin mjedisor. Pjesëmarrëse në seminare dhe konferenca të ndryshme ndërkombëtare të organizuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Mjedisit të Komisionit Evropian, nga Agjencia Evropiane e Mjedisit (EEA), UNEP, UNEP/MAP, UNESCO, NATO, IMPEL, MEDPOL, TAIEX/ECRAN OSBE etj.

Është autore, bashkautore në disa publikime ndërkombëtare në fushën e të drejtës mjedisore. Ajo flet anglisht, italisht, bullgarisht dhe zotëron njohuri bazë të maqedonishtes.